

MET-ENGINEERING sh.p.k

Pasqyrat Financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

Së bashku me Raportin e Audituesit të Pavarur

PËRMBAJTJA:

	FAQE
RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR	1
PASQYRAT FINANCIARE:	
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	3
PASQYRA E PERFORMANCËS	4
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	5
PASQYRA E FLUKSIT TË MJETEVE MONETARE	6
SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE	7 – 18

RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR

Për Menaxhimin dhe ortakun e vetëm të Shoqërisë MET-ENGINEERING shpk

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Shoqërisë **MET-ENGINEERING shpk** (Shoqëria), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më datën 31 Dhjetor 2016, pasqyrën e performancës, pasqyrën e fluksit të mjeteve monetare dhe pasqyrën e ndryshimeve në kapital për vitin e mbyllur në këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë më datën 31 Dhjetor 2016, performancën e saj financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuar në Shqipëri.

Baza për Opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuar, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Shoqërisë për të vazhduar aktivitetin e saj në bazë të parimit të vijimësisë, shënimet shpjeguese, si edhe për çështjet që lidhen me vazhdimësinë e aktivitetit të shoqërisë, duke përdorur parimet bazë të vazhdimësisë, përveç rastit kur drejtimi ka për qëllim të likuideojë aktivitetin, ose të ndërpresë aktivitetin operacional, ose nuk ka asnjë alternativë tjetër reale përveçse më lart.

Palët e ngarkuara me qeverisjen janë përgjegjëse për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.


Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional gjatë gjithë periudhës së auditimit. Gjithashtu ne:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve, planifikojmë dhe zbatojmë procedurat përkatëse për zbutjen e këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidencë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të krijuar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e mashtrimit është më i lartë se rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e gabimit, për shkak se, mashtrimi mund të përfshijë fshehje të informacionit, falsifikim të informacionit, përvetësime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Marrim një kuptueshmëri të atyre kontrolleve të brendshme relevante për procesin e auditimit me qëllim hartimin e procedurave të auditimit në përputhje me rrethanat, por jo për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël të kryera si edhe paraqitjen në shënime shpjeguese përkatëse të bëra nga Drejtimi.
- Shprehemi në lidhje me përshtatshmërinë e parimit të vijimësisë, bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, mbi ekzistencën e një pasigurie materiale mbi aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi aktivitetin e saj. Nëse një pasiguri materiale ekziston, ne duhet të tërheqim vëmendjen në shënimin shpjegues përkatës, nëpërmjet raportit tonë të auditimit, ose nëse shënimet shpjeguese nuk janë të përshtatshme ne duhet të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona jepen mbi bazën e evidencës së auditimit të marrë deri më datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojnë ndërprerje të aftësisë së Shoqërisë për vijimësi.
- Vlerësojmë paraqitjen, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare dhe të shënimeve shpjeguese dhe në rast se ato përfaqësojnë drejt transaksionet dhe ngjarjet.

Ne komunikojmë me personat të ngarkuar për qeverisjen e Shoqërisë, përveçse çështjeve të tjera, edhe objektin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet kryesore të auditimit, përfshirë çdo mangësi relevante në kontrollin e brendshëm të identifikuar gjatë auditimit tonë.


Irena Hoxha (Pulo)
Auditues Ligjor

 MAZARS

Rr. Emin Duraku, Pall. "Binjaket",
No.5, 1000, Tirana, Albania
phone : +355 42 27 80 15
www.mazars.al . info@mazars.al

31 Maj 2017

Met-Engeneering Sh.p.k

*(Vlerat janë në Lek)*Pasqyra e Pozicionit Financiar
më 31 dhjetor 2016

	Shënime	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
AKTIVE			
Aktive afatshkurtra			
Mjete monetare	4	1,952,282	403,542
Llogari te arketueshme tregetare	5	35,753,829	30,298,041
Te tjera llogari te arketueshme	6	74	-
Inventari	7	34,323,268	5,445,219
Shpenzime te shtyra	8	7,977,997	652,249
Total Aktive Afatshkurtra		80,007,450	36,799,051
Aktivet afatgjata			
Aktive afatgjata material	9	1,737,068	196,423
Total aktive afatgjata		1,737,068	196,423
Total Aktive		81,744,518	36,995,474
DETYRIMET			
Detyrime afatshkurtra			
Llogari te pagueshme tregetare	10	75,125,522	26,734,926
Detyrime tatimore	11	1,181,278	1,593,284
Te ardhurat e shtyra	12	916,667	4,583,333
Te tjera detyrime	13	942,692	1,553,203
Total Detyrime afatshkurtra		78,166,159	34,464,746
Detyrime afatgjata			
Total Detyrime afatgjata		-	-
Totali i detyrimeve		78,166,159	34,464,746
Kapitali aksionar			
Kapitali i nenshkruar	14	10,000	10,000
Rezerva ligjore		1,000	-
Rezerva te tjera		2,519,728	-
Fitimi i ushtrimit		1,047,631	2,520,728
Total kapitali aksionar		3,578,359	2,530,728
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		81,744,518	36,995,474

Pasqyra e pozicionit financiar duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 18, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Met-Engeneering Sh.p.k

(Vlerat janë në Lek)

**Pasqyra e Performancës
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016**

	Shenime	31Dhjetor2016	21Janar- 31.12.2016	01- 20Janar2016	31 Dhjetor 2015
Te ardhura nga aktiviteti i shfrytezimit Ndryshimi ne inventarin e produkteve te gatshme dhe prodhimit ne proces	15	243,687,118	243,687,118	-	27,561,868
Te ardhura te tjera te shfrytezimit	17	2,117,274	2,117,274	-	217,324
		393,789	393,789	-	(22,048)
Lenda e pare dhe materiale te konsumueshme		(208,355,203)	(208,355,203)	-	(22,088,206)
1) Lenda e pare dhe materiale te konsumueshme	18	(207,377,860)	(207,377,860)	-	(22,015,691)
2)Te tjera shpenzime	19	(977,343)	(977,343)	-	(72,515)
Shpenzime te personelit	20	(33,360,458)	(33,360,458)	-	(2,940,796)
1) Paga dhe shperblime		(28,516,991)	(28,516,991)	-	(2,513,701)
2) Shpenzime te sigurimeve shoqerore/shendetsore (paraqitur vecmas nga shpenzimet per pension)		(4,843,467)	(4,843,467)	-	(427,095)
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	9	(253,960)	(253,960)	-	(2,894)
Shpenzime te tjera te shfrytezimit	21	(2,546,674)	(2,546,674)	-	(169)
Shpenzime financiare	22	34	34	-	46
1) Shpenzime interesi dhe shpenzime te ngjashme (paraqitur vecmas shpenzimet per t'u paguar tek njesite ekonomike brenda grupit)		1,211	1,211	-	46
2) Shpenzime te tjera financiare		(1,177)	(1,177)	-	-
Fitimi/humbja para tatimit		1,681,920	1,681,920	-	2,725,125
Shpenzimiitatatimitmbifitimin	23	(634,289)	(634,289)	-	(204,397)
1) Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin		(634,289)	(634,289)	-	(204,397)
Fitimi/humbjaevetit		1,047,631	1,047,631	-	2,520,728
Te ardhura te tjera gjithperfshirese per vitin:		-	-	-	-
Totali i te ardhurave te tjera gjithperfshirese per vitin		-	-	-	-
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin		1,047,631	1,047,631	-	2,520,728

Pasqyra e performancës duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 18, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Met-Engeneering Sh.p.k*(Vlerat janë në Lek)***Pasqyra e ndryshimeve në Kapital
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016**

	Kapitali i nënshkruar	Rezerva statutore	Rezerva të tjera	Fitimi / humbja e vitit	Totali
Pozicioni financiar më 01 janar 2015	-	-	-	-	-
Fitimi / humbja e vitit	-	-	-	2,520,728	2,520,728
Emetimi i Kapitalit	10,000	-	-	-	10,000
Pozicioni financiar i rideklaruar më 31 dhjetor 2015	10,000	-	-	2,520,728	2,530,728
Fitimi / humbja e vitit	-	-	-	1,047,631	1,047,631
Lëvizjet përmes kapitalit	-	1,000	2,519,728	(2,520,728)	-
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2016	10,000	1,000	2,519,728	1,047,631	3,578,359

Pasqyra e ndryshimeve në kapital duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 18, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare të Shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 u nënshkruan si më poshtë më _____ nga:

Gazmend Metohu
Administratör



Griselda Metaj
Ekonomiste

MET-ENGINEERING
SH.P.K.
TIRANE-ALBANIA



Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

Shenime	31 Dhjetor 2016	31 Dhjetor 2015
Flukset e parasë nga aktivitetet operative		
Fitim / Humbja e vitit	1,047,631	2,520,728
Rregullimet për shpenzimet jomonetare:		
Shpenzimet financiare jomonetare	16,128	21,983
Shpenzimet për tatimin mbi fitimin jomonetar	429,892	193,980
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	253,960	2,894
Provizione	-	
Ndryshimet në aktivet dhe detyrimet e shfrytëzimit:		
Rënie/(rritje) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera	(12,781,610)	(30,950,290)
Rënie/(rritje) në inventarë	(28,878,048)	(5,445,219)
Rritje/(rënie) në detyrimet e pagueshme	43,824,552	32,997,562
Rritje/(rënie) në detyrime për punonjësit	(553,031)	1,273,203
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit	3,359,474	614,841
Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata materiale	(1,794,606)	(199,317)
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit	(1,794,606)	(199,317)
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit		
Arkëtime nga emetimi i kapitalit aksionar		10,000
Pagesa e huave	(1,177)	
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit	-1,177	10,000
Rritje/(rënie) neto në mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare	1,563,691	425,524
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 1 janar	403,542	-
<i>Efekt i luhatjeve të kursit të këmbimit të mjeteve monetare</i>	(14,951)	(21,982)
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 31 dhjetor	4 1,952,282	403,542

Pasqyra e fluksit të parasë duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 18, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

1. Informacion i përgjithshëm

"Met-Engeneering" sh.p.k (Kompania) është themeluar si një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar më 18 Gusht 2015 në përputhje me Ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" me NIPT L52025007R.

Kapitali themeltar i shoqërisë është 10,000 Lek (dhjetë mijë), i zotëruar 100% nga ortaku i vetëm i Kompanisë, Z. Gazmend Metohu. Administrator i shoqërisë është Z. Gazmend Metohu.

Aktiviteti kryesor i kësaj kompanie ka të bëjë me veprimtarinë në fushën e ndertimit të përgjithshëm; veprimtari në fushën e projektimit dhe zbatimit; veprimtari në fushën e ujësjellës – kanalizimeve; veprimtari në fushën e prodhimit të veprave të artit, skulptura, piktura, skica, grafitë, mozaikë; veprimtari në fushën e tregimit të materialeve të ndërtimit, si dhe të veprave të artit brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Selia e shoqërisë është në adresën: Rr. "Unaza e Re", godinë banimi dhe shërbimi, njësia II 04, Tiranë.

Më 31 dhjetor 2016 Shoqëria kishte 80 punonjës (2015: 63).

2. Bazat e përgatitjes së paqyrave financiare

2.1 Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara (SKK) dhe ligjin nr. 9228, datë 29 prill 2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare". Në bazë të urdhrit nr. 64 datë 22.7.2014 "Për shpalljen e standardeve kombëtare të kontabilitetit të përmirësuara dhe zbatimin e detyrueshëm të tyre", Ministria e Financave vendosi të bëjë të detyrueshëm zbatimin e Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara duke filluar nga 1 janar 2015.

Ky urdhër hyri në fuqi me fletoren zyrtare nr.119, datë 1 gusht 2014.

2.2 Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.3 Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë prezantuar në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

2.4 Vlerësime dhe gjykime

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon nga drejtuesit të ushtrojnë gjykimin e tyre në procesin e zbatimit të politikave kontabël të shoqërisë dhe shumave të raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultati aktual mund të ndryshojë nga këto vlerësime.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël janë të njohura në periudhën në të cilën vlerësimi është rishikuar si dhe në periudhat e ardhshme që preken. Në veçanti, informacion mbi fushat më të rëndësishme të vlerësimeve dhe gjykimeve në aplikimin e politikave kontabël të cilat kanë efektet më të rëndësishme në shumat e njohura në pasqyrat financiare, janë përshkruar në shënimet përkatëse të pasqyrave financiare. Përdorimi i vlerësimeve kontabël është minimal në këto pasqyra financiare duke patur parasysh thjeshtësinë e veprimeve të realizuara nga Shoqëria.

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare (vazhdim)**2.5 Krahasueshmëria e informacionit kontabël**

Siç paraqitet në Standardin Kombëtar të Kontabilitet të përmirësuar nr. 1, në rastet e një ndryshimi në paraqitjen e pasqyrave financiare si pasojë e kërkesave të një standardi të ri, një përmirësimi në standard apo një ndryshimi në ligjin "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", informacioni krahasues duhet të riparaqitet për të korresponduar me paraqitjen e re, përveç rasteve kur riparaqitja e informacionit krahasues nuk mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme.

3. Politikat Kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

3.1 Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisht të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmben në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2016 është detajuar si më poshtë:

Kursi i këmbimit	2016	2015
EUR/Lek	135.23	137.28
USD/ Lek	128.17	125.79

3.2 Instrumenta financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbje, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivitetet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivitetin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivitetin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

(Vlerat janë në Lek)

3. Politikat kontabël (vazhdim)

3.2 Instrumenta financiarë (vazhdim)

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provigjioni për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provigjionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve.

Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përlllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

Kapitali

Kapitali themeltar njihet me vlerën nominale.

3.3 Aktive afatgjata materiale

i. Njohja dhe matja

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivitetit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivitetit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivitetit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivitetit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktiviteti afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

ii. Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afat-gjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

(Vlerat janë në Lek)

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.3 Aktive afatgjata materiale (vazhdim)

iii. Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivitetit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivitetet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivitetit.

Jetëgjatësia e vlerësuar për vitin 2016 dhe 2015 është si më poshtë:

Aktive	2016 Përqindja	2015 Përqindja
Pajisje zyre dhe informatike	25%	25%
Instrumenta dhe vegla pune	20%	20%

Metoda e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen në çdo datë raportimi.

3.4 Aktivet financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktiviteti.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuara, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivitetet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivitetet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivitetet financiare të matura me kosto të amortizuara, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3.5 Provigjonet

Një provigjion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provigjionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë.

3.6 Njohja e të ardhurave

Të ardhurat nga shërbimet e ofruara njihen në pasqyrën e të ardhurave në varësi të fazës së përfundimit të transaksionit në datën e bilancit. Asnjë e ardhur nuk njihet nëse ka pasiguri të lartë lidhur me kryerjen e pagesës dhe kostove përkatëse.

3.7 Të ardhura dhe shpenzime financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit, që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare, të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

3. Politikat kontabël (vazhdim)

3.8 Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2016 është 15%.

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përllogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

Gjendjet e shtyra tatimore maten me normat tatimore në fuqi ose që konsiderohen në fuqi në fund të periudhës së raportimit, të cilat pritet të zbatohen për periudhën kur diferencat e përkohshme do të anulohen ose humbja tatimore e mbartur do të shfrytëzohet.

Aktivet tatimore të shtyra për diferencat e përkohshme të zbritshme regjistrohen deri në atë masë që është e mundshme që fitimi i tatueshëm në të ardhmen të mund të përdoret për zbritjet në fjalë.

4. Mjete monetare

Mjetet monetare për vitin që mbyllet më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2016</u>	<u>31 dhjetor 2015</u>
Mjete monetare në bankë	1,906,047	265,468
Llogari rrjedhëse	1,906,047	265,468
Mjete monetare në arkë	46,235	138,074
	<u>1,952,282</u>	<u>403,542</u>

5. Llogari të arkëtueshme tregtare

Llogaritë e arkëtueshme më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2016</u>	<u>31 dhjetor 2015</u>
Klientë	35,753,829	30,298,041
	<u>35,753,829</u>	<u>30,298,041</u>

6. Të tjera llogari të arkëtueshme

Detyrimet doganore më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2016</u>	<u>31 dhjetor 2015</u>
Detyrime doganore	74	-
	<u>74</u>	<u>-</u>

Met-Engeneering Sh.p.k
Shënime shoqëruese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

(Vlerat janë në Lek)

7. Inventari

Inventari më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 është si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2016</u>	<u>31 dhjetor 2015</u>
Lëndë e parë dhe materiale	31,988,670	5,227,895
Produkt i gatshëm	2,334,598	217,324
	<u>34,323,268</u>	<u>5,445,219</u>

8. Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra

Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2016</u>	<u>31 dhjetor 2015</u>
Shpenzime të periudhave të ardhme	7,728,000	-
Parapagime	249,997	652,249
	<u>7,977,997</u>	<u>652,249</u>

Met-Engeneering Sh.p.k
 Shënime shoqëruese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
 (Vlerat janë në Lek)

9. Aktive afatgjata materiale

	Instrumenta dhe vegla pune	Automjetet	Pajisje kompjuterike	Totali
<i>Kosto</i>				
Gjendja më 1 janar 2015	-	-	-	-
Shtesa	168,400	-	30,917	199,317
Nxjerrje jashtë përdorimit	-	-	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2015	168,400	-	30,917	199,317
<i>Shtesa</i>				
Nxjerrje jashtë përdorimit	466,776	1,050,000	277,829	1,794,605
-	-	-	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2016	635,176	1,050,000	308,746	1,993,922
<i>Amortizimi i akumuluar</i>				
Gjendja më 1 janar 2015	-	-	-	-
Amortizimi i vitit	(2,250)	-	(644)	(2,894)
Nxjerrje jashtë përdorimit	-	-	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2015	(2,250)	-	(644)	(2,894)
<i>Amortizimi i vitit</i>				
Nxjerrje jashtë përdorimit	(93,120)	(122,500)	(38,340)	(253,960)
-	-	-	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2016	(95,370)	(122,500)	(38,984)	(256,854)
<i>Vlera neto kontabël</i>				
Gjendja më 31 dhjetor 2015	166,150	-	30,273	196,423
Gjendja më 31 dhjetor 2016	539,806	927,500	269,762	1,737,068

10. Llogari të pagueshme tregtare

Llogari të pagueshme tregtare më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2016</u>	<u>31 dhjetor 2015</u>
Furnitorë vendas	75,118,317	26,734,926
Furnitorë për fatura të pambërritura	7,205	-
	<u>75,125,522</u>	<u>26,734,926</u>

11. Detyrime tatimore

Detyrimet tatimore më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 paraqiten të detajuara si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2016</u>	<u>31 dhjetor 2015</u>
Kontribute për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore	568,424	699,544
Tatim mbi të ardhurat nga punësimi	7,800	7,790
Tatim fitimi	429,892	193,980
TVSH për t'u paguar	175,162	691,970
	<u>1,181,278</u>	<u>1,593,284</u>

12. Të ardhurat e shtyra

	<u>31 dhjetor 2016</u>	<u>31 dhjetor 2015</u>
Parapagime të marra nga klientët	916,667	4,583,333
	<u>916,667</u>	<u>4,583,333</u>

13. Të tjera detyrime

	<u>31 dhjetor 2016</u>	<u>31 dhjetor 2015</u>
Detyrime ndaj personelit	720,172	1,273,203
Të tjera detyrime	222,520	280,000
	<u>942,692</u>	<u>1,553,203</u>

14. Kapitali aksionar

Kapitali themeltar i Shoqërisë është në vlerën 10,000 Lek, i cili zotërohet 100% nga ortakut i vetëm i shoqërisë, Z. Gazmend Metohu.

	<u>31 dhjetor 2016</u>	<u>31 dhjetor 2015</u>
Numri i kuotave	1	1
Vlera nominale (në Lek)	10,000	10,000
Kapitali aksionar	<u>10,000</u>	<u>10,000</u>

Fitimi i ushtrimit të Shoqërisë për vitin 2016 është në vlerën 1,047,631 Lek (2015: 2,520,728 Lek).

Met-Engeneering Sh.p.k
Shënime shoqëruese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

(Vlerat janë në Lek)

15. Të ardhura nga shitja

Të ardhurat nga veprimtaria e zakonshme për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 paraqiten si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015</u>
Të ardhura nga punime ndërtimi për të tretë	143,335,100	14,231,400
Të ardhura nga shitja e mallrave e materialeve	98,198,608	2,403,420
Të ardhura nga shitja e produktit të gatshëm	2,153,410	10,927,048
	<u>243,687,118</u>	<u>27,561,868</u>

Më poshtë analizohet rakordimi i të ardhurave të deklaruara në Pasqyrën e Performancës dhe ato të deklaruara në FDP –në e TVSH-së dhe Tatim Fitimit:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016</u>
Shitje total të deklaruara në FDP TVSH	240,020,455
Ndryshimi i gjendjes së parapagimeve të marra	3,666,666
Shitje të deklaruara në FDP që janë të ardhura në PASH	<u>243,687,121</u>
Punime ndërtimi për të tretë	143,335,100
Të ardhura nga shitja e materialeve, mallrave dhe PG	100,352,018
Shitje të deklaruara në FDP që janë të ardhura në PASH	<u>243,687,118</u>
Të ardhurat nga interesat bankare	1,211
Fitim nga këmbimet valutore	613,143
Total të ardhura të deklaruara në FDP e Tatim Fitimit	<u>244,301,472</u>
Deklaruar FDP e Tatim Fitimit	<u>244,301,472</u>

16. Ndryshimi në inventarin e produkteve të gatshme dhe prodhimit në proces

Ndryshimi në inventarin e produkteve të gatshme paraqitet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015.

	<u>31 dhjetor 2016</u>	<u>31 dhjetor 2015</u>
Ndryshimi në inventarin e produkteve të gatshme	2,117,274	217,324
	<u>2,117,274</u>	<u>217,324</u>

Met-Engeneering Sh.p.k
 Shënime shoqëruese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
 (Vlerat janë në Lek)

17. Të ardhura të tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 paraqiten të detajuara si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2016</u>	<u>31 dhjetor 2015</u>
Fitime nga këmbimet valutore	613,143	-
Humbje nga këmbimet valutore	(219,354)	(22,048)
	<u>393,789</u>	<u>(22,048)</u>

18. Materiale të para dhe të konsumueshme

Kostoja e materialeve të para dhe të konsumueshme për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 paraqitet si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015</u>
Kosto e materialeve të para	92,298,294	18,430,502
Kosto e mallrave	79,881,741	-
Nënkontraktor	28,330,965	3,577,272
Mirëmbajtje riparime	356,825	7,917
Shpenzime transporti për shitje / blerje	671,453	-
Shpenzime certifikimi	925,794	-
Qera	4,912,788	-
	<u>207,377,860</u>	<u>22,015,691</u>

19. Shpenzime të tjera të shfrytëzimit

Këto shpenzime janë analizuar në tabelën e mëposhtme:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015</u>
Qera zyre	146,000	-
Konsulencë ekonomike-juridike	90,000	-
Taksa të ndryshme	488,726	5,120
Shpenzime telefon, internet	146,996	-
Shërbime bankare	48,662	9,044
Shpenzime administrative	56,959	33,200
Shpenzime të ndryshme	-	25,151
	<u>977,343</u>	<u>72,515</u>

20. Shpenzime personeli

Shpenzimet e personelit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 paraqiten si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015</u>
Shpenzime për paga	28,416,991	2,513,701
Shpenzime për sigurime shoq e shënd	4,843,467	427,095
Shpenzime të tjera për punonjësit	100,000	-
	<u>33,360,458</u>	<u>2,940,796</u>

Numri i punonjësve më 31 dhjetor 2016 është 80. (2015: 63).

21. Shpenzime të tjera

Shpenzime të tjera për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 paraqiten si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015</u>
Gjopa dhe penalitete	2,546,674	169
	<u>2,546,674</u>	<u>169</u>

22. Shpenzime financiare neto

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015</u>
Të ardhura nga interesat	1,271	46
Humbje nga këmbimet valutore	(1,177)	-
	<u>34</u>	<u>46</u>

23. Tatimi mbi fitimin

Shoqëria, deri ne daten 20.01.2016 ishte subjekt i tatimit te thjeshtuar mbi fitimin. Norma e tatimit te thjeshtuar mbi fitimin eshte 7.5%. Nga data 21.01.2016 shoqëria eshte subjekt i tatimit mbi fitimin, norma e te cilit eshte 15% . Llogaritja e tatimit mbi fitimin eshte paraqitur e ndare sipas periudhave per te cilat shoqëria ka qene e regjistruar perkatesisht si taksa pagues i tatimit te thjeshtuar mbi fitimin dhe si taksa pagues i tatimit mbi fitimin.

Shoqëria per periudhen 01/01/2016-20/01/2016 qe ka qene e regjistruar si taksa pagues subjekt i tatimit te thjeshtuar mbi fitimin ne baze te ligjit ka bere deklarimin dhe pagesen e tatimit te thjeshtuar mbi fitimin perpara dates 10/02/2017.

Formularët e deklarimit të tatimit mbi të ardhurat paraqiten çdo vit pranë autoriteteve tatimore, por të ardhurat dhe shpenzimet të deklaruara për qëllime të tatueshme konsiderohen vetë deklarime deri në momentin që janë vëzhguar dhe vlerësuar nga autoritetet tatimore.

Legjislacioni tatimor dhe ligjet Shqiptare janë subjekt interpretimi nga autoritetet tatimore.

Met-Engeneering Sh.p.k
 Shënime shoqëruese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
 (Vlerat janë në Lek)

23. Tatimi mbi fitimin (vazhdim)

Përlllogaritja e shpenzimit për tatimin mbi fitimin paraqitet më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015:

	31 Dhjetor 2016	21 Janar -31 Dhjetor 2016	01-20 Janar2016	31 Dhjetor 2015
<i>Fitimi para tatimit</i>	1,681,920	1,681,920	-	2,725,125
Shpenzime te panjohura te tjera (si me poshte)	2,546,674	2,546,674	-	169
Penalitet, gjoba e demshperblime	2,546,674	2,546,674	-	169
<i>Fitimi para tatimit (perfshire shpenzimet e panjohura)</i>	4,228,594	4,228,594	-	2,725,294
Humbje fiskale e mbartur	4,228,594	4,228,594	-	2,725,294
<i>Tatim fitimi @15%, 7.5%</i>	634,289	634,289	-	204,397
	<u>1,047,631</u>	<u>1,047,631</u>	<u>-</u>	<u>2,520,728</u>

24. Angazhime dhe pasiguri

Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, Shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta. Bazuar në opinionin e drejtuesve të shoqërisë, konkluzioni përfundimtar në lidhje me këto çështje nuk do të kenë efekt negativ në pozicionin financiar të Shoqërisë ose ndryshime në aktivet neto të saj.

Më 31 dhjetor 2016, Shoqëria nuk ka angazhime kapitale të kontraktuara por ende të papaguara.

25. Ngjarje pas bilancit

Nuk ka asnjë ngjarje pas datës së bilancit e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.